

NJOFTIM
Nr. 544, datë 27.1.2021

PËR APLIKIM PËR FUNKSIONIN E KRYETARIT DHE TË NËNKRYETARIT TË KOMITETIT PËR PAKICAT KOMBËTARE

Në mbështetje të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të vendimit nr. 286, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave të përzgjedhjes së kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit për Pakicat Kombëtare”, procedura përzgjedhëse për kandidatët për kryetar dhe nënkryetar të Komitetit për Pakicat Kombëtare bëhen çdo 4 vjet dhe jo më vonë se 3 muaj pas përfundimit të mandatit, nëpërmjet një procesi të pavarur, transparent dhe gjithëpërfshirës.

Procedurat e hapura publike të konkurrimit bëhen nga Kryeministria, bazuar në pikën 4, të nenit 20, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në përfundim të mandatit të kryetarit dhe të nënkryetarit të Komitetit për Pakicat Kombëtare inkurajojmë kandidatët për aplikim.

Shpallja për aplikim do të jetë e hapur për një afat 30-ditor.

Kandidatët për kryetar dhe nënkryetar të KPK-së duhet të plotësojnë këto kriterë:

a) të jenë persona që u përkasin pakicave kombëtare, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 3, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”;

b) të jenë personalitete të shquara, me kontribute të spikatura në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare;

c) të kenë eksperiencë pune jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare.

- Dokumentet që duhet të dorëzohen janë, si më poshtë vijon:

- kërkesë për aplikim;
- kopje e letërnjoftimit;
- *Curriculum vitae* në gjuhën shqipe (secila faqe e firmosur);
- dokumente të diplomimit (të noterizuara), si dhe dokumente të përvojës në fushat e kërkuara;

- dokument që të provojë vjetërsinë në profesion;

- formular të vetëdeklarimit (të plotësuar e të firmosur), në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar;

- formular të aplikimit (të plotësuar e të firmosur) për informim për zyrtarët përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta, në zbatim të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

(Deklarimi i rremë sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme e konkurrimit dhe përgjegjësi penale, sipas legjislacionit në fuqi.)

Afati i dorëzimit të aplikimit, deri më 28 shkurt 2021.

Dokumentet e aplikimit për kryetar dhe nënkryetar të Komitetit të Pakicave Kombëtare të dorëzohen në adresën, si më poshtë vijon:

Adresa: Kryeministria

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, 1000

Tiranë, Shqipëri

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

Tel.: 00355 4 22 77 401